

CIG

**COUNCIL FOR
INCLUSIVE
GOVERNANCE**

QËNDRUESHMËRIA E BASHKËSISË SERBE NË KOSOVË

**Raport
Vjenë, Austri, Korrik 2010**

Këshilli për Qeverisje Përfshirëse

Nju Jork, 2010

HYRJE

Këshilli për Qeverisje Përfshirëse (anglisht CIG) ka organizuar një tryezë të rrumbullakët me temën: Qëndrueshmëria e bashkësisë serbe në Kosovë, e cila është mbajtur në Vjenë të Austrisë me 30-31 korrik 2010. Qëllimi i takimit ka qenë që të analizohet strategjia aktuale dhe politika udhëheqëse e liderëve serbë të Kosovës si dhe të formulohen rekomandimet politike shtesë. Pjesëmarrësit kanë qenë përfaqësues të partive politike serbe dhe nga shoqëria civile e Beogradit si dhe nga komunat shumë etnike të Kosovës. Mbledhja ka qenë pjesë përbërëse e programit lidhur me të ardhmen e bashkësisë serbe në Kosovë, i financuar dhe mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme e Zvicrës.

Pjesëmarrësit në diskutime kanë analizuar veprimet e deritashme politike dhe kanë debatuar lidhur me shumë çështje kritike me të cilat ballafaqohen sot serbët e Kosovës. Bisedimet kanë qenë të orientuara në detaje pragmatike të politikës aktuale si dhe rreth mënyrave të veprimit të cilat do ti përshtateshin situatës me prirje ndryshuese në terren. Nga pikëpamja e qëndrueshmërisë, pjesëmarrësit kanë propozuar forcimin e forcave politike të serbëve të Kosovës, zgjidhjen e problemit të strukturave paralele në shumicën e komunave serbe si dhe modifikimin e politikës së Beogradit në raport me serbët e Kosovës, duke përfshirë edhe decentralizimin e proceseve politike në atë mënyrë që serbëve të Kosovës tu lejohet roli i krijimit vetanak të politikave.

Gjatë tryezës së rrumbullakët ka ekzistuar një mirëkuptim i përgjithshëm që politika e qeverisë së Serbisë dhe e partive më të madhe të serbëve të Kosovës, në radhë të parë është e orientuar për të mbrojtur interesat kombëtare të Serbisë, integritetin territorial të Serbisë, ndërsa më pak që të merret me problemet që ndikojnë në jetën e serbëve në Kosovë. Gjithashtu ka ekzistuar një pajtueshmëri se qeveria e Serbisë duhet ta vazhdojë luftën politike kundër pavarësisë së shpallur të Kosovës, por që gjithashtu duhet të formulojë një strategji politike e cila ekskluzivisht do të merrej me çështje kyçe që lidhen me të ardhmen e serbëve të Kosovës. Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, situata politike ka vazhduar të mbetet jo stabile, fakt ky që ka pamundësuar krijimin e një strategjie politike afatgjate. Disa pjesëmarrës kanë konsideruar se veprimet e Beogradit në Kosovë, në dy vitet e fundit, lidhur me problemet e caktuara, kanë qenë më shumë reagime *ad hoc*, se sa një strategji politike në mbështetje të zhvillimit të bashkësisë serbe. Është propozuar që tani kur situata është stabilizuar deri diku, Qeveria e Serbisë si dhe partitë politike serbe në Kosovë, duhet t'ia përshtatin politikën e tyre zhvillimeve në Kosovë, para së gjithash në funksion të nevojave të banorëve serbë. Kjo politikë e tillë gjithashtu do të duhej të krijojë një dallim të qartë midis interesave kombëtare të Serbisë dhe atyre lokale të serbëve nga Kosova.

Raportet e serbëve të Kosovës me ato të institucioneve të Kosovës si dhe institucionet ndërkombëtare, kanë qenë temë e patejkalueshme e diskutimeve. Derisa bashkëpunimi i serbëve të Kosovës me institucionet qendrore nuk është konsideruar urgjent, shumë prej pjesëmarrësve në debat kanë apeluar te qeveria serbe që urgjentisht të ofrojë përkrahjen e saj për bashkëpunim në nivel lokal me institucionet e Kosovës. Strategjia e “pranimi por jo e njohjes” së institucioneve të Kosovës është propozuar si një zgjidhje kompromisi me qëllim të përmirësimit të situatës politike të serbëve të Kosovës pa i sjellë dëm betejës së Serbisë kundër pavarësisë së shpallur të Kosovës. Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare përfshirë këtu ato organizata

që pranojnë pavarësinë e Kosovës, si janë Zyra Civile Ndërkombëtare dhe shumë prej ambasadave të huaja, është konsideruar gjithashtu tejet e rëndësishme.

Diskutimet e mbajtura kanë treguar se serbët e Kosovës janë të brengosur se kanë mbetur nën hijen e kontestit të statusit – mendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, si dhe debatit për një status special për veriun e Kosovës. Vëmendja e Beogradit, Prishtinës dhe Bashkësisë Ndërkombëtare lidhur me pozicionin e tyre po vazhdon të zvogëlohet.

Ky raport prezanton mendimet dhe qëndrimet e diskutuesve ndonëse nuk ofron një pasqyrë komplete të gjithë debatit në tavolinën e rrumbullakët. Për përmbajtjen e këtij raporti përgjegjësinë ekskluzive e mban CIG-u.

REKOMANDIMET

Zhvillimi i liderëve politikë

Të krijohet një udhëheqje politike serbe në mënyrë që të artikulon dhe të jetëson synimet e bashkësisë serbe, e në rastet kur kjo është e mundur, edhe të integrohet në institucionet e Kosovës në mënyrë që të mbron interesat e serbëve nga Brenda.

Përfitime të rëndësishme janë arritur në zhvillimin politik të serbëve të Kosovës, por shumë gjëra mbesin për të bërë në drejtim të forcimit të strukturave politike partiake në mënyrë që përfaqësuesit e zgjedhur të mund të marrin vendime dhe të ndikojnë në ndryshime. Shumica e partive serbe në Kosovë janë degë të partive politike të Beogradit dhe pa ndonjë mundësi reale për të marrë vendime. Ato parti me seli në Kosovë, si është Partia e Pavarur Liberale, kanë marrë një numër të vogël votash në zgjedhjet të cilat kryesisht janë bojkotuar nga ana e bashkësisë serbe dhe ky fakt u pamundëson atyre të thonë se kanë një legjitimitet të madhe nga zgjedhësit. Përafërsisht numri i madh partive politike dhe imponimi agresiv i tyre, përkundër numrit relativisht të vogël të zgjedhësve që kanë, si dhe dallimet e tyre ideologjike, kanë sjellë deri te fragmentarizimi i spektrit politik të serbëve të Kosovës.

Procesi i zhvillimit të bashkësisë serbe nuk ka ndjekur një rrjedhë të drejtë lineare. Derisa serbët e Kosovës ia dolën të formonin koalicionin e gjerë politik “Kthimi”, në zgjedhjet e para pas konfliktit, dhe të bëheshin formacioni i tretë më i fuqishëm politik në Parlamentin e Kosovës, më vonë ato u ndanë pak a shumë në parti të vogla politike të cilat iu nënshtruan qëllimeve dhe synimeve politike mbi baza personale. Përkrah saj, armiqësitë mes shqiptarëve dhe serbëve, veçanërisht të ashpërsuara në trazirat e vitit 2004, sollën te një bojkot i plotë i institucioneve të Kosovës nga ana e përfaqësuesve serbë. Kjo mënyrë e ç’aktivizimit të serbëve nga procesi politik ka qenë njëri nga shkaktarët kryesor që sollën në dobësimin dhe përçarjen e forcave politike serbe.

Pas bojkotit politik dhe “ç’aktivizimit” të Kthimit, serbët në Kosovë kryesisht u përfaqësuan përmes degëve të partive politike serbe ku dominonte Partia Radikale Serbe dhe Partia Demokratike e Serbisë. Përkundër përpjekjeve të politikanëve të ndryshëm serbë, nuk pati mundësi rikthimi të udhëheqjes serbe përsëri tek koalicioni Kthimi. Konfliktet dhe interesat

politike midis degëve të partive serbe nga Serbia, shpesh kanë qenë fajtor për paaftësinë e serbëve të Kosovës që të shtronin bazën e legjitimitetit të udhëheqësve të vetë politikë. Për shkak të ekzistimit të këtyre anomoziteteve as koalicioni Kthimi asnjëherë nuk ia kishte dalë që të kishte një trup homogjen udhëheqësish. Kontestet midis partive serbe në Beograd shumë shpejt janë bartur edhe në degët e tyre në Kosovë.

Është e domosdoshme që partitë politike në Serbi të rishikojnë rolin e degëve të tyre në Kosovë. Me qëllim të nisjes së krijimit të një udhëheqje që ka bazën në Kosovë, këto degë të partive duhet të kenë më shumë pavarësi në sjelljen e vendimeve në nivel lokal, vendime këto që në masën më të madhe u përmbahen nevojave të serbëve të Kosovës. Degët e partive politike serbe në Kosovë janë të kyçura kryesisht në aktivitete për mbrojtjen e interesave serbe, ndërsa me çështje të interesave lokale, janë marrë shumë rrallë, në mënyrë dytësore dhe të shumtën pa sukses. Shumë pjesëmarrës gjithashtu kanë konfirmuar se ekziston një mungesë e madhe koordinimi dhe mirëkuptimit midis partive kryesore dhe degëve të tyre në Kosovë. Liderët e partive politike në Serbi disa herë kanë deklaruar se dëshirojnë që përfaqësuesit e tyre në Kosovë të merren me “probleme lokale dhe jo globale”.

Realizmi i konsolidimit politik të partive serbe në Kosovë është i vështirë derisa nuk ekziston një obligim politik i partive politike në Beograd dhe degëve të tyre në Kosovës - përfaqësuesve të qeverisë së Serbisë për të harmonizuar qëllimet politike si dhe për tu orientuar drejt formimit të një koalicioni politik që bazohet në Kosovë dhe që do të përfaqësonte ekskluzivisht interesat e serbëve të Kosovës. Hap i domosdoshëm në arritjen e këtij qëllimi është ndryshimi i rolit dhe detyrave të degëve të partive qendrorë në Beograd që i kanë në Kosovë, në mënyrë që të merren me problemet lokale, si janë inicimi i një diskutimi nga të gjithë aktorët politikë në Kosovë për formulimin e një strategjie të përbashkët, ndërsa në fazën e fundit, krijimi i një aleance politike që do të forconte serbët në zgjedhje dhe ti përfaqësojë ata në institucionet e vendit.

Në parim, partitë politike serbe nuk do të duhej të ishin kundër unifikimit të qëndrimit politik të degëve të tyre në Kosovë, por nuk pritet prej tyre që të marrin këtë iniciativë. Iniciativa në fakt do të duhej të merrej nga ana e vetë serbëve të Kosovës. Partitë e serbëve të Kosovës së pari duhet të merren vesh për një kornizë bashkëpunimi, të përcaktojnë vijat e synimeve të përbashkëta dhe pastaj planin e tyre t’ia paraqesin edhe Beogradit prej të cilit duhet të kërkojnë ndihmë. Edhe qendrat e partive politike në Beograd edhe serbët e Kosovës do të kishin dobi nga koalicioni politik i serbëve të Kosovës. Partitë në Beograd do të kishin leverdi nga qëndrimi unik i serbëve të Kosovës që do të shërbente edhe si nje burim i për dhënie të rekomandimeve politike, kurse vetë serbët e Kosovës do të shndërroheshin në një aktor aktiv politik në Kosovë.

Avancimi i strukturave partiake dhe marrëdhënieve ndërpartiake janë parakusht për një aleancë politike të suksesshme. Komunikimi i pamjaftueshëm midis partive dhe kujdesi që Beogradi të vendos për gjithë çka vetëm sa i kontribuon krijimit të ndjenjës së pafuqisë politike, dhe në një mënyrë edhe dekurajimit të iniciativave serioze nga serbët e Kosovës. Shumë politikanë serbë në Kosovë kanë pranuar se nuk kanë bërë përpjekje të mjaftueshme të bashkëpunojnë mes veti, dhe se sipas tyre, ata asnjëherë nuk i kanë propozuar Beogradit një iniciativë zyrtare për harmonizim qëndrimesh.

Bashkësia ndërkombëtare gjithashtu do të mund të ndihmonte në konsolidimin e strukturave politike të serbëve të Kosovës. Organizatat ndërkombëtare në Kosovë duhet të sigurojnë trajnime për partitë politike serbe duke u ndihmuar atyre të formulojnë platforma politike, dhe nëse është e mundur të ndihmojnë edhe krijimin e një aleance politike serbe. Bashkësia ndërkombëtare ka mundësi të jetë një aleat i rëndësishëm në mënyrë që zëri i serbëve të Kosovës të dëgjohet në institucionet e Kosovës, që ata të mos mbivotohen dhe injorohen. Pra, ata duhet të intensifikojnë bashkëpunimin me bashkësinë ndërkombëtare dhe të kërkojnë një ndihmë më të madhe financiare dhe teknike për përmirësimin e kapaciteteve politike të partive dhe institucioneve komunale në komunat me shumicë serbe.

Në parim, rrethanat e ndryshme politike të serbëve që jetojnë në jug dhe atyre që jetojnë në veri, e bëjnë të pamundur krijimin e një udhëheqjeje politike të përbashkët serbe, e cila do të përfaqësonte gjithë bashkësinë serbe në Kosovë. Ata ballafaqohen me probleme të ndryshme, prandaj aktualisht serbët në veri dhe serbët në jug kanë udhëheqjet e tyre të ndara. Shumë kush pret që deri sa të zgjidhet kontesti mes Beogradit dhe Prishtinës, interesat e serbëve në veri do të përfaqësohen nga Beogradi. Diskutimet për një ndarje të mundshme, këmbim terriroresh, apo një status të posaçëm për veriun, e bëjnë integrimin e serbëve në veri shumë pak tërheqës. Prandaj, çfarëdo force politike e unifikuar serbe në Kosovë, sipas të gjitha gjasave në një periudhë afatshkurtër do të kishte me vete vetëm serbët që jetojnë në jug të Kosovës. Megjithatë, ky do të ishte një hap i parë i mirë, vlerësuar pjesëmarrësit.

Zhvillimi institucional

Të konsolidohen institucionet në komunat me shumicë serbe dhe të gjindet një zgjidhje për të tejkaluar problemin e institucioneve paralele.

Integrimi i serbëve në Institucionet e Kosovës, që janë themeluar pas luftës, ka kaluar nëpër një proces turbulent. Serbët kanë marrë pjesë në zgjedhje dhe i janë bashkuar institucioneve, por nuk ishin në gjendje të marrin pjesë aktive në krijimin dhe realizimin e proceseve politike, kryesisht për shkak të armiqësisë ndëretnike që kanë vazhduar edhe në kohën post-konfliktuale. Megjithatë, ata ia kanë dalë të luajnë një rol kyç në këto institucione dhe të përmirësojnë pozitën e tyre. Në zgjedhjet e vitit 2004 pjesa më e madhe e serbëve ka bojkotuar zgjedhjet për institucionet e Kosovës, por nuk kanë krijuar institucionet paralele. Kjo ndryshoi, tek pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008.

Në maj të vitit 2008 tre muaj pas shpalljes së deklaratës së pavarësisë, qeveria serbe organizoi zgjedhjet e veta lokale në Kosovë dhe themeloi institucionet komunale serbe, të njohura si institucionet paralele, dhe kjo ndodhi për herë të parë pas përfundimit të konfliktit. Edhe pse këto institucione në dy vitet e para ofruan shërbime në fushën e arsimit, shëndetësisë dokumentacionit, ndarjen e ndihmave financiare për serbët e Kosovës, ekzistimi i tyre tani për mendimin e shumicës së pjesëmarrësve të tryezës, është bërë problematik në komunat me shumicë serbe në jug të Kosovës, kur serbët kanë dalë në zgjedhje për institucionet e Kosovës.

Komunat me shumicë serbe janë shumë të vogla për të pasur dy parë institucione lokale. Pjesëmarrja relativisht e lartë në zgjedhjet lokale në Partesh, Shtërpçë, Kllokot, Ranillug dhe Graçanicë flet për rritjen e legjitimitetit të serbëve të Kosovës, të zgjedhur në institucionet lokale

dhe për zvogëlim të ndikimit të institucioneve paralele. Megjithatë, eliminimi i institucioneve paralele, nuk është i preferuar sepse ato edhe më tej kanë një rol në ndihëm të serbëve. Një zgjidhje e përkohshme do të ishte zëvendësimi i tyre me staf profesionalë jopolitik që do të ishte përgjegjës për të kryer veprimtari shërbyese.

Disa nga pjesëmarrësit gjithashtu kanë propozuar kyçjen e përfaqësuesve të institucioneve paralele në punën e institucioneve lokale të Kosovës. Ky do të ishte një kombinim shtesë për të dyja palët. Përfaqësuesit e institucioneve paralele do të kishin vazhduar të shërbenin bashkësisë së vet, ndonëse në korniza të institucioneve tjera dhe kjo do të kishte rëndësi të veçantë, tani kur funksionimi efikas i institucioneve paralele po bëhet gjithnjë e më i vështirë. Institucionet e zgjedhura komunale të Kosovës gjithashtu do të kishin interes nga përfaqësuesit e institucioneve paralele, sepse do të ishte shtuar efikasiteti në plotësimin e nevojave të bashkësisë së tyre. Në tryezën e rrumbullakët ka ekzistuar një pajtueshmëri e përgjithshme se nga një marrëveshje e tillë përfitimin më të madh do ta kishin banorët lokalë serbë.

Mbështetja e Beogradit për iniciativa të tilla është kryesore. Zyrtarët e Beogradit së bashku me përfaqësuesit e institucioneve lokale duhet që të merren veshë së bashku për gjetjen e mënyrës së bashkimit të kapaciteteve të këtyre institucioneve. Serbët në këto komuna do të duhej gjithashtu që vetë të iniciojnë diskutime në mënyrë që të gjejnë modele të pranueshme të funksionimit.

Institucionet paralele për veprimtari shërbyese në jug nëpër klinika fjala vjen, kanë probleme me angazhimin e tyre. Është propozuar një formë e caktuar e integritit në sistemin shëndetësor të Kosovës. Në këtë moment, kur gati çdo çështje është e politizuar, një integrim i tillë është i pamundur, por diskutimet për gjetjen e rrugëve nuk do të duhej të ishin temë tabu. Mungesa e besimit në sistemin e shëndetësisë së Kosovës është përmendur si pengesa kryesore. Diskutimet midis përfaqësuesve të institucioneve shëndetësore të Kosovës dhe përfaqësuesve të klinikave në bashkësinë serbe, duhet të sjellin deri te mënyra e ndërtimit të këtij besimi midis banorëve në mënyrë që tu mundësohet të gjithë qytetarëve çasja e njëjtë në shërbimet shëndetësore. Disa nga pjesëmarrësit kanë potencuar se serbët në rajonin e Gjilanit duhet të bëjnë rrugë të gjata për të arritur në klinikat në qytetet e Serbisë, qoftë kjo edhe për shërbime të thjeshta mjekësore përderisa këto shërbime mund t'i kryejnë në spitalin e Gjilanit ku mund të arrijnë vetëm për disa minuta.

Arsimimi është çështja më e rëndë, pasi për serbët në jug të Kosovës nuk ekzistojnë institucione të larta arsimore. Fakulteti më i afërt në gjuhën serbe është në Mitrovicë. Shumica e studentëve serbë studiojnë në fakultete jashtë Kosovës, e siç kanë sqaruar disa pjesëmarrës të tryezës, ata nuk kthehen më në Kosovë pasi përfundojnë studimet. Sipas tyre “kanë shumë arsye të mos kthehen”. Nëse tani nuk bëhet ndonjë ndryshim, sindromi i largimit të trurit do të shkaktojë shumë dëm bashkësisë serbe në Kosovë. Graqanica është përmendur si një komunë e qëndrueshme e cila do të mund të shërbejë si një qendër urbane për serbët në jug. Themelimi i disa fakulteteve në këtë qytet do të ishte i mundur, por kjo do të kërkonte para së gjithash përkushtimin e Prishtinës dhe bashkësisë serbe. Megjithatë, shikuar në planin afatgjatë, kur arsimit të depolitizohet, atëherë do të mund të krijohen kushtet për studentët serbë për të ndjekur studimet në universitete private dhe publike, sidomos në ato universitete ku ligjëratat mbahen në gjuhën angleze. Aktualisht në mesin e serbëve është duke u zhvilluar një diskutim për arsimin e serbëve. Tashmë disa ide janë propozuar, por një strategji për këtë qëllim ende nuk është

përpiluar. Kthimi i refugjatëve është përmendur si faktor që do të kontribuonte në përmirësimin e kapaciteteve njerëzore.

Zhvillimi institucional është i një rëndësie vendimtare për qëndrueshmërinë e bashkësisë serbe në Kosovë. Serbët e Kosovës nuk mund të mbështeten shumë gjatë tek ndihmat sociale nga Serbia, sepse kjo nuk është një strategji e qëndrueshme as për serbët e Kosovës as për vetë Serbinë. Këto mjete duhet të përdoren për forcimin e institucioneve të cilat ndikojnë në krijimin e kushteve për punësim dhe konditave që do të ndikonin te serbët që të mbesin për të jetuar në Kosovë.

Politika e Beogradit

Modifikimi i prituri i politikave të Beogradit ndaj Kosovës duhet të reflektoj mendimet dhe idetë pragmatike të serbëve të Kosovës.

Politika e shteteve demokratike dhe atyre që janë në proces të demokratizimit në masë të madhe i përmbahen prioritetëve të opinionit publik. Pozicioni i ashpër i Beogradit përballë Kosovës, pas shpalljes së pavarësisë, reflektonte disponimin e opinionit publik të Serbisë dhe serbëve nga Kosova. Megjithatë, tani po krijohen opinione se mendimi i serbëve të Kosovës po ndryshon në drejtim të zgjidhjes së problemeve në mënyrë pragmatike, veçanërisht kur bëhet fjalë për çështje që janë esenciale për një zhvillim të qëndrueshëm. Pjesëmarrja relativisht e madhe e serbëve të Kosovës në zgjedhjet lokale në Partesh, Shtërpçë dhe Graçanicë tregon se serbët në jug të Ibrit janë të orientuar më shumë drejt një politike pragmatike. Megjithatë, edhe serbët në veri, gjithashtu mbështesin vendosjen e ligjit të së drejtës dhe institucioneve të cilat i realizojnë shtetin ligjor.

“Lypësi nuk mund të jetë ai që zgjedh”. Kjo klishe ilustron më së miri raportin midis Beogradit dhe serbëve të Kosovës. Serbët e Kosovës mbështeten tek Beogradi për çështje ekzistenciale dhe besojnë se ky raport u pamundëson atyre të jenë të hapur dhe të sinqertë me politikanët beogradas lidhur me nevojat politike që shtrohen. Përkrah këtij raporti varësie, edhe lidhshmëria emocionale me Beogradin është gjithashtu e madhe. Njëri nga pjesëmarrësit tha se ndonëse u ishte bashkangjitur institucioneve të Kosovës, ai gjithmonë do ta konsiderojë Serbinë si vendin e tij. Shumica e pjesëmarrësve potencoi faktin se pragmatizmi duhet aplikuar me rastin e zgjidhjes së problemeve lokale.

Ndryshimi politik duhet të fillojë me menaxhimin e fondeve: ajo që është me shumë rëndësi, është përmirësimi i udhëheqjes me fondet dhe transparenca e tyre. Gjithashtu, më shumë mjete do të duhej të orientohen kah zhvillimi i arsimit dhe institucioneve. Vendimi i Beogradit që të heq kryetarët e atyre komunave të Kosovës ku nuk ka popullatë substanciale serbe, sipas mendimit të disa pjesëmarrësve, është përshëndetur nga ana e popullatës serbe.

Serbët e Kosovës që ishin pjesëmarrës të tryezës së rumbullakët, potencuan se Beogradi duhet ti angazhoj ata aktivisht në procesin e ndërtimit të strategjisë politike për Kosovën. “Ne vetëm marrim udhëzime dhe rekomandime dhe shndërrohemi në zbatues të atyre rekomandimeve. Ne gjithashtu duhet të bëhemi pjesë e artikulimit të këtyre instruksioneve dhe rekomandimeve.” Gjatë tryezës së rumbullakët ka ekzistuar një pajtueshmëri e plotë se Serbia nuk duhet ta njohë

pavarësinë e Kosovës, por se është e domosdoshme integrimi i serbëve në institucionet e Kosovës, së paku në ato lokale. Disa nga diskutuesit deklaruan se për dallim prej serbëve të veriut, bashkëpunimi me institucionet e Kosovës për serbët në jug është i domosdoshëm dhe sipas tij shikuar në staza afatgjata kjo është e pashmangshme. Sa më parë që kjo të ndodhë aq më mirë për serbët.

Në anën tjetër politika zyrtare e Beogradit kundërshton komunikimin dhe vendosjen e bashkëpunimit midis serbëve të Kosovës dhe institucioneve të Kosovës. Një nga pjesëmarrësit tha se viktimit kryesore e këtij abstenimi të politikës së bashkëpunimit me Prishtinën janë serbët në jug të Kosovës. “Serbët në jug të Kosovës janë në mes të zjarrit që luhet nga Prishtina dhe Beogradi”. Megjithatë, është e mundur që serbët e Kosovës të bashkëpunojnë me institucionet e Kosovës për çështje ekzistenciale pa e kompromituar politikën zyrtare të Beogradit për Kosovën. Strategjia e cila mundëson që serbët të marrin pjesë në institucionet e Kosovës dhe që njëkohësisht nuk dëmton luftën e Serbisë për Kosovën, është ajo që duhet formuluar. Kjo çështje nuk do të thotë se duhet të pritet derisa Beogradi dhe Prishtina të gjejnë zgjidhjen e duhur. “Serbët në Kosovë do të mbesin minoritet edhe sikur Kosova të bëhet pjesë e Serbisë. Pra çështja e integritetit të serbëve apo heqja dorë nga ky proces nuk duhet të presë marrëveshjen midis Beogradit dhe Prishtinës.”

Ekzistojnë indikacione se Beogradi do të reagojë pozitivisht ndaj kësaj dëshire pragmatike të serbëve të Kosovës. Edhe pse Beogradi nuk ka mbështetur pjesëmarrjen e serbëve në zgjedhjet lokale në Partesh, nuk ka bërë ndonjë reagim kundër zyrtarëve të rinj serbë të zgjedhur në këto poste. Disa nga pjesëmarrësit thanë se po komunikojnë me zyrtarë të ndryshëm në Beograd se si të gjendet mënyra e përkrahjes. Një propozim tjetër ishte që të ndërtohen kanale të reja komunikimi midis elitave politike të Serbisë dhe Kosovës në mënyrë që të analizohen dhe ndahen informacionet e rëndësishme. “Për të sjellë një vendim të drejtë është e nevojshme të kesh informata valide, kurse serbët e Kosovës janë partneri më i mirë i Serbisë për të ofruar këto informata.”

Beogradi gjithashtu mund të ndihmojë në zvogëlimin e dallimeve politike midis serbëve në veri dhe atyre në jug. Serbët në veri duhet ta kuptojnë më mirë se situata e serbëve në jug është më e komplikuar. Serbët në jug mbështetet tek institucionet e Qeverisë së Kosovës për shumë nevoja, përfshirë energjinë elektrike, regjistrimin e makinave dhe sigurinë. Çështja e ndarjes së mundshme gjithashtu duhet të sqarohet: serbët në jug besojnë se ndarja nuk është opsion i mirë, sepse lë më shumë se gjysmën e serbëve të Kosovës brenda shtetit të Kosovës. Besohet se rreth 60 për qind e serbëve të Kosovës jetojnë në jug të Kosovës. Ata frikësohen se ndarja e Kosovës mund të sjellë deri te shpërngulja e tyre masive.

PËRFUNDIM

Edhe pse angazhimi i brendshëm i spektrit të gjerë të serbëve të Kosovës është parakusht për konsolidimin e udhëheqjes politike dhe forcimit të institucioneve, ndihma politike e Beogradit është e domosdoshme. Roli i Beogradit është i domosdoshëm veçanërisht në zgjidhjen e problemit të institucioneve paralele në komunat me shumicë serbe në jug të Kosovës. Komuna e Graçanicës, Shtërpçës dhe Parteshit kanë nga dy parë institucione ku edhe njëra palë edhe tjetra thonë se kanë legjitimitetin e popullit. Ndonëse janë arritur disa marrëveshje të përkohshme se

mes tyre nuk do të ketë pengesa në punën e njëri-tjetrit, ekziston edhe më tej një potencial për konteste në të ardhmen gjë që do të ishte në dëm të banorëve serbë. Pjesëmarrësit e tryezës kanë propozuar se zgjidhjet afatgjata duhet të përmbajnë interesin e qytetarëve të këtyre komunave. Interesi i komunave është që të kenë institucione që janë të pozicionuara mirë me qëllim të përparimit të interesit të qytetarëve.

Serbët e Kosovës, duke pasur parasysh faktin se Beogradi nuk ka kontroll ndaj territorit të Kosovës, kanë propozuar që të ndihmohet në formulimin e një politike pragmatike që do të ishte e realizueshme. Shumë vendime politike të qeverisë së Serbisë në dy vitet e kaluara nuk kanë marrë në konsideratë këtë fakt, ndërsa si rezultat është dëshmuar pamundësia e ndryshimeve praktike. Konsolidimin e një politike e cila do tu përgjigjej nevojave të bashkësisë serbe, zyrtarët e Beogradit dhe serbët e Kosovës duhet ta bëjnë përmes një analize të përbashkët të politikës së deritashme dhe të opsioneve politike, që të identifikojnë pengesat që dalin me rastin e realizimit të këtyre politikave dhe të krijojnë institucione të tilla të obligueshme për realizimin e saj. Qëllimi i një politike të tillë është që të modifikohet politika e caktuar dhe që të përmirësohet efikasiteti i institucioneve.

Pjesëmarrësit e tryezës së rrumbullakët janë pajtuar që Beogradi dhe Prishtina duhet të bashkëpunojnë më afër në mënyrë që të krijohet një strategji e qartë mbështetëse për vetëqëndrueshmëri të bashkësisë serbe në Kosovë. Definicioni i tyre i vetëqëndrueshmërisë nënkupton një bashkësi serbe të fortë politikisht dhe institucionalisht, e cila është e aftë që të mbrojë vetë interesat e saj.

PJESËMARRËSIT

Radhitja sipas alfabetit

Lukas Beglinger, Ministria e Jashtme e Zvicrës
Nenad Cvetkovic, Iniciativa Qytetare “Zavicaaj”, Partesh
Shpetim Gashi, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
Alex Grigorev, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
Oliver Ivanovic, Qeveria e Republikës së Serbisë, Beograd
Dusan Janjic, Forumi për Marrëdhënie Etnike, Beograd
Vesna Jovanovi_, Partia Socialdemokrate, Partesh
Bratislav Nikolic, Partia e Pavarur Liberale, Shterpcë
Nebojsa Peric, Grupi Qytetar Vidovdani, Graqanicë
Vesna Pesic, Partia Liberale Demokratike, Beograd
Slobodan Petrovic, Partia Liberale e Pavarur, Prishtinë
Nenad Radosavljevic, Radio/TV Most, Leposaviq
Zivojin Rakocevic, Gazetar, Qagllavicë
Norbert Ruetsche, Ministria e Jashtme e Zvicrës
Bojan Stojanovic, Partia Liberale e Pavarur, Graqanicë
Caroline Tissot, Ministria e Jashtme e Zvicrës
Momcilo Trajkovic, Lëvizja e Rezistencës Serbe, Graqanicë
Rada Trajkovic, Lëvizja Evropiane e Serbëve, Graqanicë
Ivan Vejvoda, Fondi Ballkanik për Demokraci, Beograd